



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I EDUKIMIT

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 229 201 • E-mail: edukimi@uni-pr.edu • edukimi.uni-pr.edu

TEZAT E MASTERIT PËR DISKUTIM PUBLIK TË MIRATUARA NGA
DEPARTAMENTI I PEDAGOGJISË

NITA ABAZI

Tema: Praktikrat e menaxhimit demokratik në institucione parashkollore

Komisioni:

Prof. Ganimete Kulinxha, mentore

Prof. Majlinda Gjellaj, kryetare,

Prof. Arlinda Beka, anëtare

Abstrakt

Në botën e civilizuar demokracia është e dëshiruar dhe kërkohet, sepse i jep të drejta njeriut për fjalën e lirë dhe për një gjithëpërfshirje. Për tu zbatuar demokracia, duhet të ketë menaxhim të tillë, që ofron praktika me frymë demokratike. Menaxhimi demokratik si mënyrë e udhëheqjes që lejon të praktikohen e ushtrohen detyra e përgjegjësi, duke e shprehur mendimin e lirë, duke marrë pjesë në vendimmarrje, duke bashkëpunuar dhe udhëhequr së bashku, ka një rëndësi të madhe në mënyrën e realizimit të punës nga ana e stafit, në efikasitetin e asaj pune, në bashkëpunimin në mes stafit, në motivimin e stafit, si dhe në ngritjen e cilësisë edhe në IP.

Në vende të ndryshme të botës, ky stil i menaxhimit në IP praktikohet mjaftë shumë, duke i afirmuar vlerat dhe të drejtat e çdo pjesëmarrësi në aktivitetet e IP-së, duke filluar nga fëmijët, prindërit, edukatorët, mirëmbajtësit, kuzhinieri, pedagogu, psikologu, administratori dhe deri tek udhëheqësi, kështu duke ofruar dhe krijuar një frymë motivuese.

Trajtimi i problemit "Praktikimi i menaxhimit demokratik në IP" është realizuar duke e përdorur metodën e përzier (cilësore dhe sasore), ndërsa instrumentet e mbledhjes së të dhënave janë Pyetësi dhe Intervista. Hulumtimi u realizua në komunën e Prishtinës dhe mostra përbëhet nga edukatorët, prindërit dhe drejtorët e institucioneve parashkollore. Hipoteza e këtij hulumtimi është: "Jetësimi i menaxhimit në frymën demokratike në IP arrihet duke praktikuar vlerat, si: liria e shprehjes, bashkëpunimi, bashkëqeverisja dhe gjithëpërfshirja".

Pyetjet e hulumtimit, të cilat besuam që e vërtetuan hipotezën janë: Cilat janë vlerat demokratike në menaxhim në IP?, Si promovohen vlerat demokratike gjatë udhëheqjes në IP? dhe Cilat janë vështirësitë që e pengojnë menaxhimin demokratik në institucione parashkollore?.

Rezultatet e këtij hulumtimi na japin të kuptojmë që gjatë menaxhimit të IP-ve nga drejtorët, praktikohet një menaxhim me vlera demokratike, ku këto vlera promovohen gjatë punës me edukatore dhe prindër. Në anën tjetër, drejtorët hasin në vështirësi gjatë menaxhimit demokratik për shkak të përgatitjes profesionale të edukatoreve, moshës së shtyer, shkathtësive profesionale, etj.

Fjalët kyçe: Demokraci, Praktika e menaxhimit, Menaxhim demokratik, Vlera demokratike, Institucion parashkollor.

DAFINA HALILI

Tema: Qëndrimet e edukatoreve ndaj ndryshimeve në kurrikulë prej vitit 2000 deri 2018

Komisioni:

Prof.dr. Naser Zabeli;
Prof.asoc. Majlinda Gjelaj;
Prof.Asoc. Arlinda Beka

Abstrakti

Qëllimi i këtij punimi të masterit është identifikimi i qëndrimit të edukatoreve ndaj ndryshimeve kurrikulare që kanë ndodhur në Kosovë. Ndryshme këto që kanë paraqitur sfidat dhe nevojat e ndryshimeve për sukses. Ballafaqimi i drejtpërdrejt me ndryshimet që vazhdimisht kanë ndodhur në sistemin e arsimit në Republikën e Kosovës ka dashur një vëmendje të shtuar për realizimin e plan programeve dhe aktiviteteve për parafillor. Ndryshimet përmbajtjesore të kurrikulës që nga viti 2000 deri në 2018 janë vërejtur në qëndrimet e edukatoreve. Përshtatja e ndryshimeve nga edukatorët rezultoi me përshtatshmërinë e plan programeve dhe aktiviteteve të tyre ku do të pasqyrojmë përmes shembujve të rezultateve që do të nxjerrim në këtë punim. Realizimi i këtij hulumtimi është udhëhequr nga pyetjet kërkimore, si: 1. Cili është qëndrimi i edukatoreve ndaj ndryshimeve në kurrikulë gjatë viteve 2000 – 2018? 2. Cilat janë vështirësitë e edukatoreve me ndryshimet e ndodhura në kurrikulë? 3. A ka dallim në qëndrimet mes edukatoreve sipas vendit ku punojnë lidhur me ndryshimet dhe përparësitë e ndryshimeve?

Për mbledhjen e të dhënave është zbatuar qasja sasimore, ndërsa si instrument është përdorur pyetësori me një mostër prej 146 edukatoresh prej tyre 4 edukatorë.

Të dhënat e hulumtimit tregojnë se ka dallime në qëndrimet e edukatoreve sa i përket edhe ndryshimeve të sistemit, Kurrikulave si dhe kohës së ngarkesës. Ndërsa dallime domethënëse në qëndrimet e tyre janë evidentuar mes edukatoreve që punojnë me fëmijët përgatitor në fshat nga ato në qytet. Gjithashtu bazuar në të dhënat e hulumtimit shihet se niveli i informimit të tyre me ndryshimet nuk ka qenë i mirë.

Fjalët kyçe: *ndryshim i kurrikulës, qëndrim, përmbajtje kurrikulare, ngarkesa kurrikulare, edukimi parashkollor*

ARDITA PIREVA

Tema: Roli i komunikimit të drejtorit të shkollës në menaxhimin e institucionit

Komisioni:

Prof. Nusret Pllana, mentor

Prof. Ganimete Kulinxha, kryetare

Prof. Ethem Ceku, anëtar

Abstrakti

Komunikimi është çdo proces në të cilin njerëzit ndajnë një informacion, ndajnë ide dhe ndjenja. Ai nuk përfshin vetëm fjalët e folura apo të shkruara por edhe gjuhën e trupit dhe stilin pra çdo gjë që i shtohet kuptimit të një mesazhi. Meqë modeli i shkollave ka ndryshuar shumë prej pikëpamjeve tradicionale, mund të thuhet se një transformim të tillë e ka pësuar edhe komunikimi. Ndërtimi i raporteve të shëndosha ndërmjet mësimitdhënësve dhe nxënësve apo udhëheqësve dhe mësimitdhënësve bëhet vetëm nëpërmjet të komunikuarit efektiv. Këtë komunikim e karakterizon qasja që drejtorët krijojnë ndaj mësimitdhënësve. Me zhvillimin e hovshëm të Teknologjisë së Informacionit drejtorët dhe mësimitdhënësit kanë mundësi që komunikimin e tyre ta shndërrojnë në produktivitet.

Qëllimi i kësaj teme të diplomës është ofrimi dhe analiza e formave komunikuese efektive në udhëheqje. Këtu nuk do të ndalem vetëm te ajo që njihet si komunikim verbal, pra të shprehurit përmes fjalëve por edhe te komunikimi joverbal, i cili për shkak se përdoret shumë, ka rëndësi të posaçme. Nga shqyrtimi i literaturës është vërejtur se këtij lloji të komunikimit nuk i është kushtuar rëndësia e duhur. Duke e trajtuar me kujdes, konsideroj se do të mund t'iu shërbente udhëheqësve për ta përvetësuar dhe përdorur si duhet me stafin e tyre dhe me nxënës.

Të gjitha këto të dhëna do të nxirren përmes zbatimit të metodës sasiore dhe cilësore, ku kriter do të jetë të shprehurit e rezultateve të kërkimit nëpërmjet intervistës me mësimitdhënësit dhe drejtorë, ndriçimin e përvojave të veçanta të mësimitdhënësve dhe drejtorëve, të cilat pastaj do të grumbullohen dhe përpunohen statistikisht. Qëllimi i hulumtimit është që të shqyrtojë rëndësinë e komunikimit të drejtorit të shkollës në institucionin arsimor që drejton. Pyetjet të cilat do të përdoren gjatë këtij hulumtimi janë:

Çfarë ndikimi ka komunikimi i drejtorit në institucionin arsimor?,

Si ndikon mënyra e komunikimit të drejtorit tek mësimitdhënësit dhe tek personeli?.

Grupi reprezentativ që do të jetë i përfshirë është: dy shkolla të mesme të ulëta dhe dy shkolla të mesme të larta të qytetit të Prishtinës si dhe një shkollë e mesme e ulët nga komuna e Podujevës. Numri i respondentëve që përfshihen në grupin reprezentativ janë 50 mësimitdhënës dhe 5 drejtorë shkollash. Metodatat e hulumtimit që do të përdoren në këtë studim janë: metoda e analizës teorike, metoda e krahasimit dhe metoda statistikore kurse instrumentet e hulumtimit janë: Pyetësori për mësimitdhënës dhe anketa me drejtorët e shkollave.

Përmes këtij hulumtimi do të paraqes dhe adresoj nevojën e një komunikimi adekuat, të drejtë, të sinqertë, human të drejtorit ndaj mësimitdhënësve, nxënësve, prinderve dhe personelit të institucionit që menaxhon.

Fjalët kyçe: *Komunikim, drejtor, mësimitdhënës, nxënës, shkollë.*

MEDINA XHURAJ

Tema: Sfidat dhe përparësitë e përdorimit të platformës “E-shkollori” sipas përvojave të udhëheqësve dhe mësimit në shkollat fillore

Komisioni:

Prof.Asoc.Dr.Kastriot Buza, mentor

Prof.Ass.Dr. Kyvete Shatri, kryetare

Prof.Asoc.Dr. Majlinda Gjellaj, anëtare

ABSTRAKTI

Tema “Sfidat dhe përparësitë e përdorimit të platformës “E-shkollori” sipas përvojave të udhëheqësve dhe mësimit në shkollat fillore të Prishtinës” do të shtjellohet si temë diplome në master me synimin për të vënë në pah sfidat dhe përparësitë ose vështirësitë dhe të mirat e platformës E-shkollori, platformë kjo e krijuar për të lehtësuar mësimin në distancë gjatë pandemisë COVID-19 në vitin 2020.

Si pasojë e virusit COVID-19 ka rezultuar mbyllja e shkollave në të gjithë botën. Shumë fëmijë kanë mbetur jashtë klasës. Si rezultat, arsimit ka ndryshuar në mënyrë dramatike, me rritjen e dallueshme të e-mësimin, përmes së cilës mësimi ndërmerret në distancë dhe në platforma dixhitale. Mendohet se të mësuarit përmes platformave online është treguar i suksesshëm, që do të thotë se ndryshimet që ka shkaktuar virusi COVID-19 mund të jenë këtu për të qëndruar dhe për të na shërbyer edhe më pas.

Duke marrë parasysh që në Kosovë nuk është praktikuar një formë e tillë e mësimin më parë, natyrisht që ka pasur nevojë për përmirësime, risi e ndryshime.

Përmes këtij studimi pritet t’i përgjigjemi pyetjes kryesore të hulumtimit : “Cilat janë përparësitë dhe sfidat e platformës E-shkollori sipas udhëheqësve e mësimit në shkollat fillore të Prishtinës?”. Pra qëllimi i këtij studimi është të vë në pah sfidat dhe përparësitë sipas udhëheqësve e mësimit në përdorimin e kësaj platforme.

Në këtë studim është përdorur metodologjia mikse, pasi kemi të bëjmë edhe me të dhëna sasiore, të cilat janë mbledhur përmes pyetësorëve, por edhe me të dhëna cilësore që janë mbledhur përmes intervistave.

Me anë të këtij studimi presim të kuptojmë a janë përmbushur pritshmëritë e udhëheqësve për platformën E-shkollori si dhe të kuptojmë sfidat që kanë hasur ata gjatë përdorimit të kësaj platforme.

Fjalët kyçe: *E-shkollori, mësimit në distancë, platformë, udhëheqësit.*

FLAMUR PAJAZITI

Tema: Rëndësia e kurrikulave zgjedhore dhe përzgjedhja e tyre nga nxënësit e shkollave profesionale

Komisioni:

- 1. Arlinda Beka-mentore**
- 2. Naser Zabeli-kryetar**
- 3. Rozafa Ferizi-Shala-anëtare**

Abstrakti

Që nga viti 2000, janë bërë reforma në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, duke filluar prej themelimit të institucioneve përkatëse të sistemit arsimor, krijimin e infrastrukturës ligjore dhe profesionale, gjatë këtyre viteve janë hartuar dhe aprovuar ligje e Udhëzime Administrative, dokumente të cilat e rregullojnë funksionimin e arsimit parauniversitar .

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) me dokumentet e Kurrikulës, si Kornizën e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar dhe Kurrikulat, përcakton një shkallë më të lartë të autonomisë dhe përgjegjësisë së shkollës në planifikimin dhe zbatimin e kurrikulës së re. Të gjitha Kurrikulat Bërthamë të arsimit parauniversitar përfshijnë edhe kurrikulën me zgjedhje, e cila përcaktohet nga shkolla me qëllim që nxënësit të zgjedhin lëndë, module apo projekte sipas interesimit për zhvillim profesional të tyre. Pasi që ka bazë të mirë ligjore për organizimin e kurrikulavezgjedhore përmes këtij punimi kam realizuar hulumtimin në tri Shkollat e Mesme Profesionale (ShMP), për të parë se si bëhet organizimi, funksionimi dhe zgjedhja e mësimit zgjedhor.

Qëllimi i këtij hulumtimi është që të nxjerr të dhëna se si është kuptuar lënda zgjedhore nga nxënësit, mësime dhënësit dhe drejtorët?, çfarë rëndësie i japin kurrikullës zgjedhore shkollat?, a bëhet ndërlidhja e lëndëve me nevojat e nxënësve për zhvillimin profesional të tyre, si bëhet zgjedhja dhe si organizohet mësimi me zgjedhje në Shkollat e mesme profesionale (ShMP).

Ky hulumtim është realizuar përmes metodologjisë mikse (sasiore dhe cilësore) me qëllim që të nxjerrë një rezultate sa më të sakta, të hulumtimit. Mostra e këtij hulumtimi janë: drejtorët, mësime dhënësit dhe nxënësit e tri nga ShMP. të komunës së Vitisë e Gjilanit. Rezultatet e këtij hulumtimi tregojnë vështirësitë me të cilat përballen nxënësit dhe mësime dhënësit e ShMP., gjatë zgjedhjes dhe organizimit të lëndës, modulit apo projektit zgjedhorë.

Rezultatet e daluranga ky hulumtim tregojnë se rëndësia e kurrikulava zgjedhore nuk është kuptuar sa duhet, ShMP., nuk ju ofrojnë nxënësve të drejtën e përzgjedhjes së lëndës zgjedhore sipas interesimit për zhvillim profesional të tyre. Edhe pse ka bazë ligjore për organizimin e kurrikulës zgjedhore, ajo nuk zbatohet gati në asnjë rast për organizimin e kurrikulës zgjedhore dhe përzgjedhjen e moduleve, projekteve apo lëndën zgjedhore.

Fjalët kyçe: Kurrikula me zgjedhje, Lëndët zgjedhore, Projektet, Modulet, ShMP.

ARJETA GURGUROVCI

Tema: Ndërlidhja midis perceptimeve pozitive për matematikën dhe vetëbesimit të nxënësve për zgjidhjen e detyrave

Komisioni:

Prof. Xhevat Krasniqi, mentor

Prof. Vlora Sylaj, kryetare

Prof. Teuta Danuza, anëtare

ABSTRAKTI

Studimi i këtij hulumtimi është i rëndësishëm pasi përfundimet nga ky studim ndihmojnë mësimdhënësit e matematikës që t'i njohin perceptimet e nxënësve për matematikën dhe ndërlidhjen e perceptimeve të nxënësve në raport me vetëbesimin e tyre për zgjidhjen e detyrave matematikore.

Literatura në lidhje me këtë temë na jep disa qasje të ndryshme të cilat krahasohen me analizimin e rezultateve nga pyetësi. Sipas autorëve të ndryshëm nxënësit kanë një perceptim pozitiv për matematikën dhe vetëbesimi lidhet ngushtë me rezultatet e nxënësve në zgjidhjen e detyrave. Literatura gjithashtu thotë së djemtë kanë perceptim më pozitiv për matematikën se vajzat dhe kjo lidhet drejtpërdrejt me vetëbesim më të lartë për zgjidhjen e detyrave matematikore.

Metodologjia e këtij hulumtimi është e përzier pasi kemi të bëjmë me literaturë nga autorë të ndryshëm dhe më hulumtim nëpërmjet pyetësorit. Nga i cili pritet të arrihen përfundime në pjesën e parë për perceptimet e nxënësve për matematikën ndërsa në pjesën e dytë për ndikimin e perceptimeve në vetëbesim për zgjidhjen e detyrave matematikore.

Analiza e të dhënave është bërë nëpërmjet programit SPSS. Të dhënat janë marrë drejtpërdrejt nga shkolla dhe janë sistemuar në program për përpunim dhe janë interpretuar gjithmonë duke i krahasuar edhe me literaturë.

Nga ky hulumtim janë vërtetuar të gjitha hipotezat. Vërtetohet se nxënësit kanë perceptime pozitive për matematikë dhe ato ndikojnë pozitivisht në vetëbesimin e nxënësve për zgjidhjen e saktë të detyrave që drejtpërdrejt ndikon në rezultate pozitive. Gjithashtu vetëbesimi që ndikon në zgjidhjen e detyrave më shumë të vajzat sesa të djemtë. Ka ndërlidhje midis perceptimeve të nxënësve për matematikën në vetëbesimin për zgjidhjen e saktë të detyrave.

Fjalët kyçe: *ndikimet të nxënësve, perceptimi për matematikën, vetëbesimi.*

ARBNORE PODRIMAJ

Tema: Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënien/mësimnxënien e gjuhës angleze

Komisioni:

Prof. Kyvete Shatri, mentore

Prof. Agnesa Canta, kryetare

Prof. Sylejman Berisha, anëtare

Abstrakt

Teknologjia është një mjet efektiv për nxënësit që i ndihmon ata në të nxënë, zhvillon aftësitë e tyre dhe i përmirëson ato. Nxënësit duhet të përdorin teknologjinë si një pjesë të rëndësishme të procesit të tyre të të mësuarit. Mësuesit duhet të modelojnë përdorimin e teknologjisë për të mbështetur kurrikulën në mënyrë që nxënësit të mund të rrisin përdorimin e vërtetë të teknologjisë në mësimin e aftësive të tyre gjuhësore. Bashkëpunimi i nxënësve mund të rritet përmes teknologjisë. Bashkëpunimi është një nga mjetet e rëndësishme për të mësuar. Nxënësit bashkëpunojnë për të krijuar detyra dhe për të mësuar nga njëri-tjetri duke lexuar punën e bashkëmohatarëve të tyre. Qëllimi i këtij studimi është të ofrojë informacion mbi përdorimin e teknologjisë në mësimdhënien dhe mësimnxënien e gjuhës angleze. Metodologjia e përdorur në këtë studim është një metodë mikse (duke mbledhur të dhënat në terren - përmes intervistave dhe pyetësorëve të strukturuar). Numri i përgjithshëm i nxënësve të përfshirë në këtë hulumtim ishte 100 nxënës (50 nga gjimnazi "Bedri Pejani" dhe 50 tjerë nga gjimnazi privat "Cambridge" në Pejë). Atyre iu kërkua të përgjigjen për rolin teknologjik në zhvillimin e procesit të mësimnxënies së gjuhës angleze në shkollë. Nga rezultatet e fituara u evidentua se teknologjia shpesh herë përdorej në klasë për mësimin e gjuhës së huaj, kohëve të fundit, teknologjia është përdorur për të ndihmuar dhe përmirësuar mësimin e gjuhës. Mësuesit kanë inkorporuar forma të ndryshme teknologjike për të mbështetur procesin e mësimdhënies dhe për të angazhuar nxënësit në procesin e të mësuarit së gjuhës angleze në shkollë.

Fjalët kyçe: *Teknologji, nxënës të gjuhës, proces, tekste mësimore, mësues.*

BEHIJE QELA

Tema: Qëndrimet e mësimitdhënësve dhe nxënësve rreth rolit të pedagogut në organizimin e procesit mësimor

Komisioni:

Prof. Dr. Naser Zabeli;
Prof. Asoc. Dr. Januz Dërvodeli;
Prof. Ass. Adhurim Rasimi.

Abstrakt

Sistemi arsimor në Kosovë vazhdimisht kërkon përmirësime të mësimitdhënies, ku tashmë mësimitdhënësia është e bazuar në kompetenca dhe drejton nxënësit drejt së ardhmes. Që të arrihet kjo, është bërë studimi për punën që bënë pedagogu me mësimitdhënës për të arritur ngritjen e efikasitetit të organizimit të procesit mësimor. Pedagogu i shkollës është organizator dhe këshillëdhënës i drejtpërdrejtë i përgatitjes, i organizimit dhe zhvillimit të punës edukative në shkolla, përmes përcjelljes dhe vlerësimit permanent të punës së gjithmbarshme në shkollë.

Qëndrimet e mësimitdhënësve dhe nxënësve për rolin e pedagogut në organizimin e procesit mësimor janë pozitive apo përkrahen dhe janë të mirësëardhura si nga mësimitdhënësit ashtu edhe nga nxënësit. Këtë më së miri mund ta argumentojmë që nga planifikimi, zbatimi, përcjellja e punës dhe aktiviteteve që zhvillohen në nivel shkolle dhe jashtë kurrikulare. Përmes pyetjeve të hulumtimit është shprehur qëllimi i hulumtimit, të cilat kanë drejtuar dhe procesin e hulumtimit.

- Cili është qëndrimi i mësimitdhënësve për rolin e pedagogut në organizimin e procesit mësimor ?
- Cili është qëndrimi i nxënësve për rolin e pedagogut në organizimin e procesit mësimor?

Hulumtimi i studimit përfshin shkollat fillore publike dhe 150 mësimitdhënës dhe 200 nxënës. Hulumtimi është bërë përmes instrumentit hulumtues pyetësorit. Përmes pyetësorit është njohur ndikimi i pedagogut të shkollës në ngritjen e efikasitetit të organizimit të procesit mësimor. Rezultatet treguan se të anketuarit ishin shumica të kënaqur me pedagogun dhe ndihen të inkurajuar për t'i kërkuar këshilla pa frikën e dënimit, të cilat rezultate i kemi marrë edhe nga hulumtimi jonë. Gjithashtu, është e evidente kënaqësia me futjen e inovacioneve dhe shkëmbimin e informacionit për të reja, strategjitë, metodat dhe format e punës. Ai kontrollon procesin mësimor dhe vëzhgon punën e mësimitdhënësve, gjithashtu ai mbikëqyrë përgatitjen e procesit mësimor përmes planit ditor të mësimave të përgatitura nga mësimitdhënësit, i analizon ato dhe nëse është e nevojshme u jep sugjerime dhe udhëzime të nevojshme.

Fjalë kyçe: pedagog, mësimitdhënës, mësimitdhënie, shërbimi pedagogjik, ngritja e efikasitetit.

ILIRJANA MEHMETI

Tema: Efektet e mësimit online në arritjet akademike të nxënësve me nevoja të veçanta

Komisioni:

Prof. Dr. Naser Zabeli;

Prof. Ass.Ardita Devolli;

Prof. Assoc.Dr. Sylejman Berisha

ABSTRAKTI

Situata pandemike me të cilën u përball gjithë bota kufizoi zhvillimin e veprimtarive të ndryshme dhe rrjedhja e situatës imponoi gjetjen e një metode për vazhdimin e mësimit, të përshtatshme për shkollën dhe nxënësit. Shumë studime hulumtojnë krijimin e mundësive që nxënësit me nevoja të veçanta të kenë qasje në mësimin online që performanca gjatë mësimit online të jetë sa më efektive.

Qëllimi i hulumtimit është të përcaktojë efektet e mësimit online të nxënësve me nevoja të veçanta. Më thellë, qëllimi i hulumtimit është edhe të studiojë se si ndikojnë këto efekte të mësimit online në arritjet akademike të nxënësve me nevoja të veçanta. Pyetjet e studimit janë: Sa marrin pjesë nxënësit me nevoja të veçanta në mësimin online? Cilat janë efektet pozitive të mësimit online në arritjet akademike të nxënësve me nevoja të veçanta? Cilat janë efektet negative të mësimit online në arritjet akademike të nxënësve me nevoja të veçanta? Si ndikon mbështetja nga prindërit gjatë mësimit online në arritjet akademike të nxënësve me nevoja të veçanta? Konform pyetjeve janë ngritur edhe 3 hipoteza. Metodologjia e hulumtimit është sasiore. Mostër e studimit janë 63 prindër dhe 75 mësimitdhënës të nxënësve me nevoja të veçanta, të klasave I-V. Të dhënat janë mbedhur me pyetësor drejtuar prindërve dhe mësimitdhënësve të nxënësve me nevoja të veçanta. Instrumentet që janë përdorur për studimin janë: “Të mësuarit në distancë dhe arsimimi i veçantë – Studimi i prindërve” (“Distance Learning & Special Education Parent Survey”) (Rhode Island Parent Information Network, 2020) dhe “Studimi i prindërve – Të mësuarit në distancë” (“Parent Survey - Distance Learning”) (Association of International Schools in Africa, 2020) – të modifikuar dhe të përshtatur.

Rezultatet e këtij studimi tregojnë që mësimi online ka efekt pozitiv në arritjet akademike të nxënësve me nevoja të veçanta dhe se pjesëmarrja e tyre në mësimin online ishte e njëjtë me pjesëmarrjen në mësimin fizik në shkolla.

Fjalët kyçe: *arritje akademike, covid-19, efekte negative, efekte pozitive, mësim online, nxënës me nevoja të veçanta.*

FATJONA KRASNIQI

Tema: Faktorët që ndikojnë në cilësinë dhe efektshmërinë e zhvillimit profesional në Kosovë

Komisioni:

Mentori: prof. Asoc. Dr. Blerim Saqipi

Anëtare: Prof. Asoc. Dr. Vlora Sylaj

Anëtare: Prof. Ass. Dr. Jehona Ferizi

Abstrakt

Mësimdhënësit deklarojnë shpesh se janë të lodhur nga kërkesat e shumta, trajnime të vazhdueshme, dhe shpenzime të kohës së vlefshme në angazhime të tilla. Kjo ngrit çështjen nëse zhvillimi profesional në Kosovë ka qenë efektiv dhe mirë i planifikuar dhe menaxhuar. Andaj është me rëndësi të studiohen faktorët e ndryshëm që ndikojnë në këtë perceptim.

Ky hulumtim kishte për qëllim të identifikojë faktorët që ndikojnë në efektshmërinë e zhvillimit profesional në Kosovë. Analiza është bazu në 5 nivele të ndryshme duke përfshirë përshtypjet imediate të pjesëmarrësve pas seminarit, zhvillimi i shkathësive, ndikimi dhe përkrahja organizative e deri tek ndikimi në suksesin e nxënësve. Gjatë hulumtimi janë zbatuar metodat mikse, kualitative dhe kuantitative, dhe janë përfshirë mësimdhënësit të disa vendeve dhe profileve të ndryshme në Kosovë. Të dhënat janë analizuar përmes platformës SPSS dhe përmes analizës tematike.

Hulumtimi ofroi pasqyrim të drejtë të motivimit dhe mungesës së tij tek mësimdhënësit për angazhim në format aktuale të zhvillimit profesional në Kosovë dhe arriti të ofrojë modele të ndryshme për menaxhimin e zhvillimit profesional në Kosovë në fazat e ardhshme duke identifikuar një model efektiv për planifikimin dhe menaxhimin e zhvillimit profesional në Kosovë në fazat e ardhshme.

Fjalët kyçe: *efektivitet, nivele, reflektim, trajnim, zhvillim profesional.*

NJOMZA LOSHI

Tema: Qëndrimet e mësimdhënësve të arsimit fillor në punën me nxënësit me zhvillim të vonuar mendor

Komisioni:

Prof.dr. Naser Zabeli;

Prof.as. Ardita devolli;

Prof.asoc. Teuta Danuza

ABSTRAKTI

Në vendin tonë kemi një numër jo edhe aq të vogël të nxënësve me zhvillim të vonuar mendor, duke parë këta nxënës si pjesë të ndjeshme të shoqërisë dhe duke parë që qëndrimet e mësimdhënësve ndikojnë mjaft shumë në përfshirjen e këtyre nxënësve në shkolla të rregullta, vendosa të studioj qëndrimet e mësimdhënësve ndaj nxënësve me zhvillim të vonuar mendor. Qëllimi i këtij hulumtimi është krahasimi i qëndrimeve e mësimdhënësve të arsimit fillor në punën me nxënësit me zhvillim të vonuar mendor.

Pyetjet hulumtuese në këtë hulumtim janë: “Cilat janë qëndrimet e mësimdhënësve në punën me nxënësit me zhvillim të vonuar mendor bazuar në moshën e mësimdhënësve?”, Cilat janë qëndrimet e mësimdhënësve në punën me nxënësit me zhvillim të vonuar mendor bazuar në gjininë e mësimdhënësve?”, Cilat janë qëndrimet e mësimdhënësve në punën me nxënësit me zhvillim të vonuar mendor bazuar në përvojën në arsim të mësimdhënësve?”.

Ky hulumtim është sipas qasjes sasimore dhe me dizajn krahasues, instrumenti për mbledhjen e të dhënave është pyetësori që është marrë nga një hulumtim i ngjashëm i kryer nga disa hulumtues në Turqi, i cili përmban 24 pohime me përgjigje sipas shkallës së Likertit (Özer, Nalbant, Ağlamis,, Baran, Samut, Aktop, & Hutzle, 2012). Mostër e këtij hulumtimi janë mësimdhënësit e arsimit fillor në Komunën e Mitrovicës të cilët në klasat e tyre kanë nxënës me zhvillim të vonuar mendor. Numri i këtyre mësimdhënësve pjesëmarrës marrë nga DKA-ja e Komunës së Mitrovicës është 32 mësimdhënës.

Gjetjet e këtij hulumtimi tregojnë se ekzistojnë dallime në qëndrimet e mësimdhënësve të arsimit fillor ndaj nxënësve me zhvillim të vonuar mendor. Sipas këtyre gjetjeve arrijmë në përfundim se nuk ka dallime të rëndësishme statistikore në qëndrimet e mësimdhënësve sa i përket gjinisë dhe përvojës në arsim të mësimdhënësve, ndërsa moshë është faktor i rëndësishëm që ndikon në qëndrimet e mësimdhënësve ndaj këtyre nxënësve, pra mësimdhënësit e rinj në moshë kanë qëndrime pozitive në punën me këta nxënës krahasuar me mësimdhënësit e vjetër.

Fjalët kyçe: mësimdhënësit e arsimit fillor, qëndrimet, dallimet, moshë, gjini, përvojë në arsim nxënësit me zhvillim të vonuar mendor.

JEHONA HASANI

Tema: Qëndrimet e mësimdhënësve të arsimit fillor në punën me nxënësit me dëmtime në të parë

**Komisioni: Prof.dr. Naser Zabeli;
Prof.as. Ardita Devolli;
Prof.as. Kyvete Shatri**

ABSTRAKTI

Nxënësit me dëmtime në të parë fatkeqësisht janë pjesë e thujse çdo klase në arsimin fillor. Meqë dëmtimet mund të jenë të shkallëve dhe llojeve të ndryshme, e ndryshme është edhe qasja e mësimdhënësve ndaj tyre, andaj arsyeja e zgjedhjes së kësaj teme është të studioj qëndrimet e mësimdhënësve ndaj këtyre nxënësve, bazuar në gjininë e mësimdhënësve, nivelin e shkollimit dhe përvojën e tyre si mësimdhënës.

Qëllimi i këtij hulumtimi është krahasimi i qëndrimeve që kanë mësimdhënësit e arsimit fillor në punën me nxënës me dëmtime në të parë.

Ky hulumtim bazohet në pyetjet hulumtuese: “Cilat janë qëndrimet e mësimdhënësve në punën me nxënësit me dëmtime në të parë bazuar në nivelin e shkollimit të mësimdhënësve?”, “Cilat janë qëndrimet e mësimdhënësve në punën me nxënësit me dëmtime në të parë bazuar në përvojën e tyre si mësimdhënës?”

Hulumtimi është sipas qasjes sasiore dhe dizajni i tij është krahasues. Mbledhja e të dhënave është përmes pyetësorit. Pyetësi është zhvilluar me mësimdhënës të arsimit fillor që punojnë me nxënës me dëmtime në të parë dhe përmban pyetje demografike, si dhe 21 pohime me përgjigje sipas shkallës së Likertit që lidhen drejtpërdrejtë me qëllimin e temës, bazuar në pyetësorin që kanë shfrytëzuar disa hulumtues në Turqi (Ravenscroft, Davis, Bilgin & Wazni, 2019).

Pjesëmarrës të këtij hulumtimi ishin 27 mësimdhënës të arsimit fillor në shkollat e Komunës së Mitrovicës që në klasat e tyre kanë nxënës me dëmtime në të parë.

Hulumtimi tregoi se nuk ka dallime të rëndësishme statistikore në qëndrimet e mësimdhënësve sa i përket gjinisë së tyre, e poashtu edhe sa i përket nivelit të shkollimit të tyre. Mirëpo qëndrimet e mësimdhënësve dallojnë sipas përvojës së tyre si mësimdhënës, sepse mësimdhënësit me më pak përvojë në mësimdhënie rezultuan se kishin qëndrime më pozitive në krahasim me mësimdhënësit që kishin më shumë përvojë.

Fjalët kyçe: gjithpërfshirje, nxënës me nevoja të veçanta, dëmtime në të parë, mësimdhënës, qëndrime, dallime, gjini, përvojë, nivel i shkollimit

BLEONA LAHA

Sfidat e mësimdhënësve në menaxhimin e klasave inkluzive

Komisioni:

Prof. Dr. Naser Zabeli, mentor

Prof. As. Ardita Devolli, kryetare

Prof. Asoc. Majlinda Gjelaj, anëtare

ABSTRAKT

Tema e këtij hulumtimi ka të bëjë me sfidat e mësimdhënësve në menaxhimin e klasave inkluzive. Edukimi inkluziv është një formë e edukimit e cila erdhi si domosdoshmëri, pasi u kuptua se klasat e bashkëngjitura dhe shkollat speciale po e thellonin ndarjen në mes të fëmijëve/nxënësve me nevoja të veçanta dhe atyre me zhvillim tipik dhe kështu po ndikonin negativisht në integrimin dhe zhvillimin e këtyre fëmijëve.

Në hyrje të këtij punimi kemi paraqitur rëndësinë e realizimit të këtij hulumtimi si dhe është paraqitur qëllimi i këtij hulumtimi i cili ishte të evidentojmë sfidat kryesore të mësimdhënësve në menaxhimin e klasave inkluzive.

Në shqyrtimin e literaturës kemi paraqitur një literaturë të gjerë të bazuar në hulumtime dhe libra të cilat flasin për sfidat me të cilat ballafaqohen mësimdhënësit gjatë punës me nxënës në klasa inkluzive.

Sa i përket metodologjisë, ky hulumtim është realizuar përmes metodës sasiore. Grumbullimi i të dhënave është i natyrës primare. Si instrument në këtë hulumtim u përdor pyetësori i gjysmëstrukturuar. Mostrën e këtij hulumtimi e përbëjnë 195 mësimdhënës nga e gjithë Kosova. Mbledhja e të dhënave u bazua në pyetjet demografike, të cilat do të përcaktojnë gjininë e pjesëmarrësit, moshën, vendin e banimit, si dhe karakteristika të tjera të cilat janë relevante për të matur faktorët me interes për këtë hulumtim. Të dhënat e marra nga hulumtimi janë përpunuar dhe analizuar me ndihmën e programit SPSS.

Analizat e të dhënave na tregojnë se 62% e mësimdhënësve e kanë të vështirë zhvillimin e mësimin në klasa inkluzive, 28% e tyre deklaruan se deri diku është sfidë për ta dhe 10% e mësimdhënësve deklaruan se nuk është aspak e vështirë të punohet në klasa inkluzive. Në kapitullin e fundit, te konkludimet tregojnë se pavarësisht përmirësimit dhe vetëdijesimit të dukshëm të edukimit inkluziv dhe stigmatizimit që fëmijët me nevoja të veçanta hasin, mësimdhënësit ende hasin shumë sfida gjatë mësimdhënies në klasat e edukimit inkluziv.

Fjalët kyçe: *Edukim inkluziv, mësimdhënës, nxënës, sfidat e mësimdhënësve.*

SHQIPONJE KAMBERI

Strategjitë e drejtorit për menaxhimin efektiv të raporteve të mësimdhënësve në shkollë

Komisioni:

Prof. Asoc. Teuta Danuza

Prof. dr. Januz Dervodelli

Prof. Asoc. Blerim Saqipi, mentor

ABSTRAKTI

Tema e këtij hulumtimi ka të bëjë me përdorimin e strategjive të drejtorëve për menaxhimin efektiv të raporteve ndërmjet mësimdhënësve në shkollë. Duke pasur parasysh faktin që bashkëpunimi dhe raportet ndërkolegiale janë të një rëndësie të madhe për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe arritjen e rezultateve të parapara, rezultatet e arritura në këtë hulumtim janë më se të dobishme dhe të rëndësishme për të kuptuar se cilat strategji janë duke përdorur udhëheqësit e shkollës për të menaxhuar raportet e mësimdhënësve në shkollë.

Në këtë hulumtim është përdorur metoda e përzier, sasiore dhe cilësore që ka mundësuar arritjen e përgjigjeve të cilat lidhen me pyetjet që iu drejtohen mësimdhënësve dhe drejtorëve për menaxhimin dhe bashkëpunimin në shkollë. Për mbledhjen e të dhënave sasiore është përdorur pyetësi për drejtorë të shkollës dhe pyetësi për mësimdhënës, ndërsa për mbledhje e të dhënave cilësore është përdorur intervista me drejtorë të shkollave. Të dhënat sasiore janë analizuar me metodën statistikore përmes programit SPSS, ndërsa ato cilësore përmes analizës tematike.

Hulumtimi është realizuar me mësimdhënës dhe drejtor të shkollave të komunave të Prishtinës. Në hulumtim kanë qenë 105 mësimdhënës që kanë marrur pjesë në plotësimin e pyetësorëve dhe 10 drejtor të cilët kanë marrur pjesë në plotësimin e pyetësorëve dhe realizimin e intervistës.

Pyetja kryesore e këtij hulumtimi është: Cilat janë strategjitë efektive që përdorë drejtori në krijimin e raporteve produktive ndërmjet mësimdhënësve për krijimin e një klime të mirë ndërkolegiale?

Sipas rezultateve të arritura të këtij hulumtimi, arrijmë të kuptojmë se drejtorët përdorin strategji nga më të ndryshmet duke i përshtatur me kërkesat e stafit të shkollës, në mënyrë që të ketë raporte sa më të mira dhe bashkëpunuese ndërmjet mësimdhënësve. Hulumtimi definon edhe aspektet të cilat janë nën zonën e ndikimit të udhëheqësve të shkollave, aspektet kolegjiale që duhet të fuqizohen si dhe identifikon mundësitë e avancimit të bashkëpunimit kolegjial në shkollë e në të cilën gjë kanë rol të rëndësishëm edhe udhëheqësit e shkollave.

Fjalët kyçe: *drejtor, menaxhim, mësimdhënës, raport, strategji.*